



KANS

KOSOVO • AIR
NAVIGATION •
• SERVICES

Titulli: RRB-KANS-01
Versioni: 1.0
Klasifikimi: Brendshëm
Faqe: 1 of 16

REPUBLIKA E KOSOVES		AGENCIA E SHËRBIMEVE TË NAVIGACIONIT AJROR	
REPUBLICA OF KOSOVO		AGENCY FOR AIR NAVIGATION SERVICES	
ZYRA E PËRSHKUES			
NAVIGATION OFFICE			
Nr. ID:	17	Data:	29.04.25
Br. sh:		Datum:	
Pg. no:		Date:	
Nr. prot.:	0203		
St. prot.:			
Prot. no:			
		N-T	LIPJAN, RKS

RREGULLORE PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE FUNKSIONIMIN E OFRUESIT TË SHËRBIMEVE TË NAVIGACIONIT AJROR

Në pajtim me nenin 4 (paragrafi 6), nenin 11 (paragrafi 1.2) dhe nenin 30 (paragrafi 1) të Ligjit NR.08/L-305 Për Ofruesin e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, Këshilli Mbikëqyrës në Mbledhjen e mbajtur me datë 29.04.2025 nxjerr këtë:

RREGULLORE PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM TË OFRUESIT TË SHËRBIMEVE TË NAVIGACIONIT AJROR

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

1. Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e organizimit të brendshëm të Ofruesit të Shërbimeve të Navigacionit Ajror (tani e tutje KANS), si një subjekt i pavarur juridik, i themeluar në përputhje me kërkesat e Ligjit NR.08/L-305 Për Ofruesin e Shërbimeve të Navigacionit Ajror si dhe përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësi të njësive organizative të KANS.

2. Ky dokument shërben edhe si Statut i Ofruesit të Shërbimeve të Navigacionit Ajror.

Neni 2

Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj rregulloreje janë të zbatueshme për personelin e KANS dhe për anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të KANS.

II. THEMELIMI DHE FORMA E ORGANIZIMIT TË KANS

Neni 3

Themelimi i Ofruesit të Shërbimeve të Navigacionit Ajror (KANS)

1. KANS është themeluar me Ligjin NR.08/L-305 për Ofruesin e Shërbimeve të Navigacionit Ajror si subjekt i pavarur juridik shtetëror në shërbim të interesit publik, për të siguruar infrastrukturën dhe shërbimet e navigacionit ajror në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës.

2. KANS ofron shërbime të navigacionit ajror në hapësirën ajrore të Kosovës ose cilëndo hapësirë tjetër ajrore për të cilën Kosova është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajror.

3. Të drejtat dhe detyrimet e Republikës së Kosovës si themelues i KANS zbatohen përmes Qeverisë, përkatësisht Këshillit Mbikëqyrës të KANS si organ kryesor që udhëheq me KANS.

Neni 4

Statusi i Ofruesit të Shërbimeve të Navigacionit Ajror

1. KANS është person juridik publik i themeluar me Ligjin NR.08/L-305 për Ofruesin e Shërbimeve të Navigacionit Ajror si person juridik publik i pavarur, jofitimprurës, financiarisht autonom dhe i qëndrueshëm, në shërbim të interesit publik.

2. KANS ka autonomi të plotë operacionale, administrative dhe funksionon jashtë kornizës ligjore të administratës shtetërore dhe zyrtarëve publikë, si dhe nuk konsiderohet organizatë buxhetore në kuptim të Ligjit përkatës për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Ligjin përkatës për Buxhetin e Republikës së Kosovës.
3. KANS do të veprojë në pajtim me politikat, legjislacionin, standardet dhe marrëveshjet ndërkombëtare të zbatueshme për aviacionin civil në Republikën e Kosovës si dhe në përputhje me standardet, praktikat dhe rekomandimet e ICAO mbi shërbimet e navigacionit ajror, përmes rregulloreve të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës.
4. Drejtori Përgjithshëm bazuar në legjislacionin primar dhe sekondar mund të nxjerrë vendime, udhëzues, procedura dhe manuale të brendshme të ndërlidhura me operimin e KANS.
5. KANS ka llogari të vetën bankare në bankat e themeluara në Kosovë si dhe jashtë saj bazuar në obligimet që derivojnë nga institucionet dhe organizatat ndërkombëtare.
6. Si person juridik i pavarur, KANS ka të drejtë të lidhë kontratë dhe marrëveshje përkatëse, të jetë paditës dhe i paditur dhe të përgjigjet me kapitalin e vet për detyrimet e krijuara nga KANS.

Neni 5

Regjistrimi

1. KANS duhet t'i nënshtrohet regjistrimit në Autoritetin Tatimor të Kosovës për qëllime tatimore.
2. KANS duhet t'i nënshtrohet një procesi certifikimi për shërbimet që ofron varësisht nga kërkesat e legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës.

Neni 6

Emri dhe adresa zyrtare

1. Emri zyrtar është: "Ofruesi i Shërbimeve të Navigacionit Ajror i Republikës së Kosovës" në gjuhën shqipe, "Pružaoč Usluga u Vazdušnoj Plovidbi Republike Kosovo" në gjuhën serbe dhe "Air Navigation Services Provider of the Republic of Kosovo" në gjuhën angleze.
2. Emri i shkurtër në të gjitha gjuhët për Ofruesin e Shërbimeve të Navigacionit Ajror është: "KANS".
3. Adresa e KANS është në Vrellë, 10070 Lipjan, Republika e Kosovës.
4. KANS mund të ketë edhe zyre të tjera rajonale në lokacione të ndryshme të Republikës së Kosovës, në pajtim me nevojën e ndërlidhur me zhvillimin strategjik të institucionit.
5. KANS komunikon me publikun edhe përmes uebfaqes zyrtare, rrjeteve sociale dhe kanaleve të tjera të komunikimit të shtypur dhe elektronik, funksionimi i të cilave rregullohet në akt të veçantë.
6. Në kuptim të kësaj rregulloreje emrat në gjininë mashkullore nënkuptojnë edhe emrat në gjininë femërore dhe anasjelltas pa diskriminim.

Neni 7

Shenja dhe vula e shërbimit

1. Për funksionimin e vet, përveç emrit, KANS duhet të përdorë edhe shenjën e shërbimit (stemën/logon) që gjithashtu mund të regjistrohet në zyrën kompetente për mbrojtjen e pronësisë intelektuale.
2. KANS ka vulat në formë të rrumbullakët që përmbajnë emrin e KANS, shenjën e KANS dhe selinë e KANS.
3. Për nevoja operationale, KANS do të ketë edhe vulat drejtkëndëshe për protokoll në të cilën do të figuroj emri, logo e KANS.
4. Miratimi i shenjave dhe vulave të shërbimit të KANS bëhet nga Drejtori sipas propozimit të një komisionit përkatës.

Neni 8

Fushat e Veprimit të KANS

1. Fushat kryesore të veprimtarisë së KANS kanë të bëjnë me:
 - 1.1. ofrimin e shërbimeve të kontrollit të trafikut ajror;
 - 1.2. menaxhimin e rrjedhës së trafikut ajror dhe të hapësirës ajrore në bashkëpunim me NATO;
 - 1.3. shërbimet e komunikimit, navigacionit dhe vëzhgimit;
 - 1.4. shërbimet e informimit aeronautik;
 - 1.5. shërbimin meteorologjik aeronautik;
2. KANS është përgjegjës edhe për kryerjen e funksioneve tjera sipas legjislacionit të aplikueshëm që kanë të bëjnë me aviacionin civil në Republikën e Kosovës.

III. ORGANET UDHËHEQËSE TË KANS

Neni 9

Organet Udhëheqëse të KANS

1. Organet udhëheqëse të KANS janë:
 - 1.1 Këshilli Mbikëqyrës dhe,
 - 1.2 Drejtori Përgjithshëm.
2. Të drejtat dhe detyrimet e organeve udhëheqëse të KANS janë të përcaktuara me Ligjin për Ofruesin e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, me këtë rregullore dhe në aktet tjera të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës.

Neni 10

Këshilli Mbikëqyrës

1. Këshilli Mbikëqyrës i KANS është përgjegjës për mbikëqyrjen e përgjithshme të KANS në përputhje me mandatin e tij të përcaktuar me Ligjin Nr.08/L-305 për Ofruesin e Shërbimeve të Navigacionit Ajror.

2. Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga tre (3) anëtarë, prej të cilëve dy (2) ministra dhe Drejtori Përgjithshëm i KANS si në vijim:

- 2.1. Ministri i ministrisë përkatëse për transport, kryesues;
- 2.2. Ministri i ministrisë përkatëse për financa, anëtar dhe
- 2.3. Drejtori i Përgjithshëm i KANS, anëtar.

3. Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës kryesohen nga Kryesuesi, apo në mungesën e tij nga njëri anëtar i deleguar nga Kryesuesi.

4. Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës thirren nga Kryesuesi, i cili vendos rendin e ditës sipas propozimeve të Këshillit.

5. Mbledhjet mund të thirren edhe me kërkesë të shkruar të çdo anëtari të Këshillit Mbikëqyrës.

6. Rolin e sekretarisë së Këshillit Mbikëqyrës e kryen Kabineti i Drejtorit të Përgjithshëm.

7. Këshilli Mbikëqyrës mbledhet për aq herë sa nevojitet për veprimtarinë e KANS por jo më pak se dy (2) herë në vit.

8. Secili anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të KANS ka një (1) votë. Në rast të votave të barabarta, vota e Kryesuesit do të jetë vendimtare. Me rastin e emërimit dhe shkarkimit të Drejtorit, Drejtori përjashtohet nga votimi.

9. Përveç rasteve të përcaktuara me Ligjin Përkatës, vendimet e Këshillit Mbikëqyrës merren me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të pranishëm. Mbledhjet dhe votimet me telekonferencë dhe forma të tjera janë të lejuara.

Neni 11

Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës

1. Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës, të përcaktuara në Ligjin Nr.08/L-305 për Ofruesin e Shërbimeve të Navigacionit Ajror janë:

- 1.1. emërimi dhe shkarkimi i Drejtorit dhe Zëvendësdrejtorëve;
- 1.2. miratimi i rregulloreve të brendshme të KANS;
- 1.3. miratimi i planit një (1) dhe pesë (5) vjeçar të biznesit të KANS;
- 1.4. miratimi i Planit Vjetor të Punës;
- 1.5. miratimi i buxhetit vjetor, raportit vjetor dhe pasqyrave vjetore financiare.

2. Këshilli Mbikëqyrës për veprimtarinë e KANS i përgjigjet Qeverisë.

Neni 12

Drejtori i Përgjithshëm i KANS

1. Drejtori i përgjithshëm i KANS kryen detyrat dhe përgjegjësitë në pajtim me Ligjin për KANS.

2. Emërimi, shkarkimi dhe procedurat e ankimimit rregullohen sipas dispozitave të Ligjit për KANS dhe aktit përkatës nënligjor.

Neni 13 **Zëvendësdrejtorët e KANS**

1. Drejtori i KANS ndihmohet nga dy (2) Zëvendësdrejtorë, Zëvendësdrejtori për Shërbime Operative dhe Zëvendësdrejtori për Shërbime Administrative dhe Financiare.
2. Emërimi, shkarkimi dhe procedurat e ankimimit për pozitat e dy zëvendësdrejtoreshave rregullohen sipas dispozitave të Ligjit për KANS dhe aktit përkatës nënligjor.

Neni 14 **Detyrat dhe Kompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm**

1. Drejtori i përgjithshëm ka përgjegjësi dhe kompetenca të:
 - 1.1. Sigurojë ushtrimin e kompetencave dhe përgjegjësi të KANS në pajtim me Ligjin Nr.08/L-305 për Ofruesin e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, Ligjin përkatës për Aviacionin Civil, ligjet tjera dhe aktet relevante nënligjore në fuqi të Republikës së Kosovës, legjislacionin përkatës të Bashkimit Evropian dhe me SARP të ICAO dhe prioritet më të madh i jep ruajtjes së sigurisë të navigacionit ajror.
 - 1.2. Mbikëqyrë të gjitha çështjet e sigurisë, teknike, operative, administrative, financiare dhe ligjore, të lidhura drejtpërsëdrejti apo tërthorazi me menaxhimin dhe operimin e KANS dhe me pronat e saj.
 - 1.3. Përfaqësoj KANS në projektet dhe iniciativat vendore dhe ndërkombëtare të ndërlidhura me aktivitetet e saj.
 - 1.4. sigurojë që aktivitetet e KANS të jenë në përputhje me të gjitha dispozitat e aplikueshme ligjore.
 - 1.5. të jetë përgjegjës për tërë menaxhimin dhe vendimet operationale të KANS.
2. Drejtori i përgjithshëm gjithashtu merr të gjitha vendimet menaxheriale dhe operative për KANS dhe është përgjegjës për:
 - 2.1. përfaqësim dhe menaxhim të punëve të KANS dhe zbatimin e vendimeve të Këshillit Mbikëqyrës;
 - 2.2. përgatitje dhe propozim të planeve të biznesit, planeve vjetore dhe planeve financiare dhe dorëzim të pasqyrave financiare vjetore për miratim;
 - 2.3. ofrim të rekomandimeve në lidhje me kontraktimin e auditorit të jashtëm të KANS;
 - 2.4. angazhim të personelit në pajtim me ligjin përkatës dhe aktet përkatëse nënligjore;
 - 2.5. kryerje të veprimtarive tjera në përputhje me ligjin përkatës dhe rregulloret e brendshme të KANS.
3. Në rast se Drejtori mungon, atë e zëvendëson Zëvendësdrejtori për Shërbime Operative ose Zëvendësdrejtori për Shërbime Administrative dhe Financiare.
4. Në rast se mungojnë në të njëjtën kohë edhe Zëvendësdrejtorët, Drejtori autorizon me shkrim njërin nga Menaxherët për zëvendësimin e përkohshëm të tij.



KANS

KOSOVO • AIR
NAVIGATION
• SERVICES

Titulli: RRB-KANS-01
Versioni: 1.0
Klasifikimi: Brendshëm
Faqe: 7 of 16

Neni 15

Detyrat dhe përgjegjësitë e zëvendës drejtoreve

1. Zëvendës drejtori për Shërbime Operative ka përgjegjësi dhe kompetenca të:
 - 1.1. ndihmojë Drejtorin në caktimin e prioriteteve dhe mbikëqyrjen e të gjitha çështjeve teknike dhe operative që lidhen me menaxhimin dhe operimin e KANS;
 - 2.2. punojë me departamentet operative për caktimin e objektivave kryesore dhe realizimin e tyre sipas dispozitave ligjore.
 - 2.3. me autorizim të veçantë të Drejtorit, Zëvendës drejtorit për Shërbime Operative mund t'i delegohen përgjegjësi të caktuara që me ligj i janë dhënë Drejtorit.
2. Zëvendës drejtori për Shërbime Administrative Financiare ka përgjegjësi dhe kompetenca të:
 - 3.1. ndihmojë Drejtorin në caktimin dhe mbikëqyrjen e të gjitha çështjeve administrative dhe financiare që lidhen me menaxhimin dhe operimin e KANS;
 - 3.2. punojë me departamentet administrative për caktimin e objektivave kryesore dhe realizimin e tyre sipas dispozitave ligjore.
 - 3.3. me autorizim të veçantë të Drejtorit, Zëvendës drejtorit për Shërbime Administrative Financiare mund t'i delegohen përgjegjësi të caktuara që me ligj i janë dhënë Drejtorit.
3. Zëvendës drejtorët shërbejnë me orar të plotë dhe për punën e tyre i raportojnë Drejtorit.

Neni 16

Personeli i KANS

Në pajtim me Ligjin 08/L-305 për Ofruesin e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, Ligjin përkatës të Punës, të kësaj Rregulloreje dhe në përputhje me standardet dhe praktikat ndërkombëtare në fushën e navigacionit ajror, marrëdhënia e punës së personelit të KANS, përfshirë rekrutimin, pozitat, funksionimin, të drejtat dhe detyrimet, disiplina, ankimimi, orari i punës, vlerësimi, përfundimi i marrëdhënies së punës, si dhe kompensimi do të rregullohen me akt të veçantë.

Neni 17

Përfaqësimi i KANS

1. Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për drejtimin dhe përfaqësimin e KANS.
2. KANS mund të përfaqësohet edhe nga njëri prej Zëvendës drejtorëve për përfaqësim të KANS në rastet e mungesës së Drejtorit të Përgjithshëm.
3. Në zbatim të kompetencave të veta të përcaktuara me ligj dhe me këtë rregullore, dhe brenda periudhës së mandatit të vet, Drejtori i Përgjithshëm mund ta bartë kryerjen e detyrave të tij specifike edhe tek Drejtorët e Departamenteve të KANS.
4. Me autorizim, Drejtori i Përgjithshëm mund të bartë tek Drejtorët e Departamenteve edhe të drejtën për të nënshkruar akte, kontrata dhe dokumente në emër të KANS, si dhe të drejtën për të përfaqësuar KANS para gjykatës dhe autoriteteve të tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.

5. Pavarësisht nga autorizimet e dhëna punonjësve të tjerë, Drejtori i Përgjithshëm mban të gjitha kompetencat dhe përgjegjësitë që i janë besuar sipas ligjit dhe me këtë rregullore.

Neni 18 **Të hyrat e KANS**

1. Të hyrat e KANS përbëhen nga:

- 1.1. tarifat e shfrytëzuesve të vlerësuara dhe të mbledhura nga KANS; dhe
- 1.2. donacionet, kreditë, grantet dhe çdo mbështetje tjetër financiare ose teknike e dedikuar për KANS.

2. Me qëllim të mbarëvajtjes së ofrimit të shërbimeve të navigacionit ajror, në rast të paqëndrueshmërisë financiare, KANS do të pranojë financim nga Buxheti i Republikës së Kosovës, si formë donacioni, granti apo huaje.

3. Për çdo vit fiskal Drejtori përgatit propozim kërkesën për buxhet dhe alokime për KANS dhe i dorëzon Këshillit Mbikëqyrës për aprovim. Përgatitjen dhe dorëzimin e dokumenteve të tilla e bënë në pajtim me kërkesat ligjore, duke marr parasysh nivelin e shpenzimeve aktuale dhe të parashikuara si dhe të hyrave të dedikuara të KANS.

Neni 19 **Tarifat e shërbimeve**

1. Tarifat e shërbimeve të ofruara nga KANS do të përfshijnë:

- 1.1. tarifat e afimit për ofrimin e shërbimit të navigacionit ajror brenda hapësirës ajrore të Kosovës; dhe
- 1.2. tarifat e mbifluturimit për avionët që janë të autorizuar për ta shfrytëzuar hapësirën ajrore të Kosovës.

2. Rregullimin e tarifave e bën AACK në përputhje me Ligjin përkatës për Aviacionin Civil.

3. KANS propozon tarifat e shfrytëzimit për shërbimet e ofruara të navigacionit ajror, në mënyrë që tarifat të jenë sa më konkurruese me tarifat e ngjashme të vendosura nga vendet e tjera në Hapësirën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit dhe të llogaritura mbi bazën e kthimit të arsyeshëm të shpenzimeve duke marrë parasysh të gjitha burimet e tjera të të hyrave.

4. AACK shqyrton dhe miraton tarifat e propozuara nga KANS në pajtim me Ligjin përkatës për Aviacionin Civil dhe informon Ministrinë për caktimin e tarifave.

5. Tarifat e shfrytëzimit janë obligative për operatorin e fluturakes. Në qoftë se operatori i fluturakes është i panjohur, detyrimi për pagesën e tarifës së shfrytëzimit bie mbi pronarin e fluturakes.

6. Regjimi i tarifave të shfrytëzimit do të përcaktohet me legjislacion për krijimin e një skeme të përbashkët tarifore për shërbimet e navigacionit ajror dhe me ndryshimet dhe plotësimet e saj. Normat e përcaktuara në këtë mënyrë sigurojnë që të mos ketë diskriminime në mes të shfrytëzuesve të ndryshëm.

7. KANS mund të refuzojë ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajror një shfrytëzuesi të hapësirës ajrore i cili shkel kushtet e pagesës përveç rasteve emergjente të aterimit.

Neni 20

Fluturimet e liruara nga tarifat e shfrytëzimit

1. Fluturimet me rregulla vizuale të fluturimit dhe avionët e shfrytëzuar nga shteti siç janë ata ushtarakë, doganorë dhe të shërbimit policor duhet të lirohen nga tarifat e shfrytëzimit.
2. Qeveria e Republikës së Kosovës duhet të sigurojë që KANS të kompensohet për fluturimet të cilat vendoset të lirohen nga pagesa e tarifave.

Neni 21

Raportimi dhe auditimi

1. KANS do të mbajë llogaritë dhe regjistrat në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) për të pasqyruar funksionalitetin e vet dhe gjendjen financiare.
2. KANS përgatit pasqyrat vjetore financiare dhe i dorëzon në Këshillin Mbikëqyrës jo më larg se 31 janar për miratim. Pasqyrat financiare të KANS auditohen dhe publikohen jo më vonë se deri me 30 qershor për vitin paraprak.
3. Llogaritë, librat kontabël dhe pjesa administrative e KANS auditohen në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, nëpërmjet kontraktimit të një kompanie profesionale për kryerjen e auditimit të brendshëm. E njëjta kompani e auditimit nuk mund të angazhohet për më shumë se tri (3) vite të njëpasnjëshme.
4. Auditori të cilit i është dhënë një kontratë nga KANS për kryerjen e një auditimi nuk ka të drejtë pas përfundimit të asaj kontrate të punësohet ose angazhohet nga KANS për një periudhë tre (3) vjeçare.
5. KANS duhet t'ua dorëzojë pasqyrat e audituara financiare Këshillit Mbikëqyrës për miratim.
6. Drejtori është përgjegjës që Këshillit Mbikëqyrës t'i dorëzojë pasqyrat e audituara financiare të KANS së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë para finalizimit dhe aprovimit të tyre.
7. KANS duhet të publikojë raportin vjetor dhe pasqyrat e audituara financiare në ueb-faqen e KANS.
8. KANS po ashtu është subjekt i auditimeve për shërbimet operative, të cilat janë të brendshme dhe të jashtme. Auditimet e brendshme realizohen përmes Departamentit për Cilësi, Siguri dhe Sigurim (DCSS), ndërsa të jashtmet realizohen nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës (AACK) në pajtim me Ligjin përkatës për aviacion civil..
9. Departamentet dhe njësit brenda KANS, përgatisin raportet të rregullta mujore, tremujore, vjetore dhe sipas kërkesës nga Kabineti i Drejtorit. Raportet mujore dhe tremujore, dërgohen më së largu deri me datë 15 të muajit vijues, ndërsa raportet vjetore dërgohen më së largu deri me 31 Janar të vitit vijues.
10. Raporti vjetor do të përfshijë, të gjitha informatat relevante mbi aktivitetet dhe objektivat e arritura gjatë vitit të raportimit, listën e projekteve, burimet financiare të investuara.
11. KANS raportet vjetore ia dërgon Këshillit Mbikëqyrës, jo më vonë se deri më 31 mars të vitit vijues për vitin paraprak fiskal.

12. Si entitet publik, KANS gjithashtu është subjekt i auditimeve nga Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës.

IV. ORGANIZIMI I FUNKSIONIMIT TË KANS

Neni 22

Struktura e brendshme

1. KANS ka një strukturë organizative funksionale, e cila siguron një ndarje të përshtatshme të detyrave dhe aktiviteteve mes njësive të bazuar në ngjashmërinë e funksioneve. Të gjitha referencat në aktet e tjera të brendshme të KANS bazohen në këtë strukturë, e vendosur si Shtojca nr. 1 Organogrami i KANS të kësaj rregulloreje.

2. Niveli hierarkik në strukturën organizative të KANS, janë:

- Këshilli Mbikëqyrës;
- Drejtori i Përgjithshëm;
- Zëvendësdrejtori për Shërbime Operative;
- Zëvendësdrejtori për Shërbime Administrative Financiare;
- Menaxherët e Departamenteve;
- Udhëheqësit e Divizioneve;
- Ekspertët;
- Niveli Profesional;
- Kategoria Mbështetëse Administrative.

Neni 23

Organizimi i Departamenteve dhe Divizioneve të KANS

1. Departamentet organizohen në përputhje me parimet, standardet dhe praktikat ndërkombëtare, dhe kërkesat rregullatore të adoptuara në fushën e Navigacionit Ajror.

2. Organizimi i Departamenteve dhe Divizioneve në KANS është i ndarë, bazuar në parimin e organizimit funksional, në Departamente operative, funksionale - operative dhe administrative - financiare.

3. Kabineti i Drejtorit është përgjegjës të organizojë punën e Drejtorit të Përgjithshëm dhe ta mbështesë në të gjitha detyrat dhe përgjegjësit e tij lidhur me veprimtarinë e Ofruesit të Shërbimeve të Navigacionit Ajror.

4. Numri dhe lloji i pozitave në secilën nga njësitë, përcaktohet me Rregulloren e Brendshme për përcaktimin e pozitave të punës, përshkrimet, kompensimin dhe përfitimet tjera për tërë personelin e KANS që nxjerrët nga Drejtori i KANS, pas pëlqimit nga Këshilli Mbikëqyrës.

Neni 24 Departamentet Operative

1. Departamentet operative të KANS janë:

- 1.1. DATS - Departamenti i Shërbimeve të Kontrollit të Trafikut Ajror;
- 1.2. DTEK - Departamenti i Shërbimeve të Komunikimit, Navigacionit dhe Vëzhgimit;
- 1.3. DMET - Departamenti i Shërbimeve Meteorologjike Aeronautike;
- 1.4. DAIS - Departamenti i Shërbimeve të Informimit Aeronautik.

2. Departamenti i Shërbimeve të Kontrollit të Trafikut Ajror - është përgjegjës për menaxhimin e sigurt dhe efikas të operimeve në hapësirën ajrore për të cilën është përgjegjës KANS. Ky departament përbëhet nga Divizioni i Kullës dhe Divizioni Vajtje/Ardhje. Përgjegjësitë kryesore të këtij departamenti janë:

- 2.1 parandalimi i përplasjes së fluturakeve;
- 2.2 parandalimi i përplasjes ndërmjet avionëve në zonën e manovrimit të përplasjes ndërmjet avionëve dhe pengesave në atë zonë;
- 2.3 përshpejtimi i qarkullimit dhe mbajtjes së rregullit në trafikun ajror;
- 2.4 ofrimi i këshillave dhe informatave të nevojshme për të siguruar fluturime të sigurta dhe efikiente;
- 2.5 informimi i organizatave relevante lidhur me avionin në nevojë për kërkim dhe shpëtim.

3. Departamenti i Shërbimeve të Komunikimit, Navigacionit dhe Vëzhgimit - është përgjegjës për funksionim të rregullt të pajisjeve përmes së cilave ofrohen shërbimet e navigacionit ajror, përkatësisht që pajisjet të monitorohen, inspektohen, mirëmbahen dhe zhvillohen në përputhje me kërkesat dhe standardet ndërkombëtare të aviacionit civil dhe të navigimit ajror. Ky departament përbëhet nga Divizioni i Komunikimit/MET, Divizioni i Navigimit, Divizioni i Survejimit, Divizioni i Procesimit, Divizioni i Teknologjisë Informative si dhe Divizioni për Energji dhe Klimatizim. Përgjegjësitë kryesore të këtij departamenti janë:

- 3.1 Monitorimi dhe mirëmbajtja e sistemeve të navigacionit ajror;
- 3.2 Inspektimi dhe kalibrimi periodik i pajisjeve për të siguruar funksionimin e saktë;
- 3.3 Identifikimi dhe zgjidhja e defekteve teknike në sistemet e navigacionit;
- 3.4 Respektimi i kërkesave të organizatave ndërkombëtare të aviacionit rreth sigurisë dhe funksionalitetit të pajisjeve të navigacionit;
- 3.5 Përditësimi i sistemeve sipas kërkesave dhe teknologjive të reja;
- 3.6 Monitorimi dhe mirëmbajtja e furnizimit me energji dhe klimatizim për sistemet e navigacionit ajror;

4. Departamenti i Shërbimeve Meteorologjike Aeronautike - është përgjegjës të ofrojë për përdoruesit aeronautik të gjithë informacionin meteorologjik të përshtatshëm, të disponueshëm dhe të nevojshëm për planifikimin e një fluturimi të sigurt, të rregullt dhe efikas. Ky departament përbëhet nga Divizioni i Parashikimit, Divizioni i Vrojtimit, dhe Divizioni për Klimatologji dhe Statistika Meteorologjike. Përgjegjësitë kryesore të këtij departamenti janë:

- 4.1 Të përgatisë dhe shpërndajë të gjitha produktet në lidhje me vrojtimet, parashikimet dhe paralajmërimet meteorologjike aeronautike;
- 4.2 Të transmetojë raportet meteorologjike aeronautike në sistemin vendor dhe ndërkombëtar të telekomunikacionit;
- 4.3 Të monitorojë fenomenet e ndryshme meteorologjike dhe të njoftojë në rastin e ndryshimeve të rëndësishme;
- 4.4 Të mbikëqyrë cilësinë për të gjitha të dhënat e vëzhgimeve meteorologjike në lidhje me saktësinë dhe përgatitjen e klimatologjisë dhe statistikave meteorologjike;
- 4.5 Të ofrojë të dhënat klimatologjike dhe statistikore meteorologjike kurdo që kërkohet.

5. Departamenti i Shërbimeve të Informimit Aeronautik - është përgjegjës të furnizojë përdoruesit aeronautik me të gjithë informacionin aeronautik të përshtatshëm, të disponueshëm dhe të nevojshëm për planifikimin e një fluturimi të sigurt, të rregullt dhe efikas. Ky departament përbëhet nga Divizioni për Raportime Aeroportuale (ARO), Divizioni për NOTAM dhe për Publikimet e Informacioneve Aeronautike (AIP). Përgjegjësitë kryesore të këtij departamenti janë:

- 5.1 Të sigurojë përditësimin e Publikimeve të Informacionit Aeronautik sipas kërkesave ndërkombëtare për shkëmbimin e informacionit aeronautik;
- 5.2 Të sigurojë menaxhimin e Planeve të Fluturimit-FPL dhe mesazheve të tjera aeronautike;
- 5.3 Të ndihmojë ekuipazhet e fluturakeve në përgatitjet për fluturim në përputhje me publikimet aktuale aeronautike dhe rregullat në fuqi;
- 5.4 Të azhurnojë dhe shpërndajë në baza ditore skemën/planin ditor të trafikut komercial dhe ushtarak duke u bazuar në të dhënat nga autoritetet përkatëse;
- 5.5 Të koordinojë lejet për operim të trafikut VFR dhe mjeteve fluturuese pa pilot me DATS, KFOR, AACK si dhe institucionet e tjera përkatëse të Republikës së Kosovës.

Neni 25

Departamentet funksionale – operative

1. Departamentet funksionale - operative të KANS janë:

- 1.1 DCSS - Departamenti për Cilësi, Siguri dhe Sigurim;
- 1.2 DZHT- Departamenti për Zhvillim dhe Trajnim.

2. Departamenti për Cilësi, Siguri dhe Sigurim – është përgjegjës për funksionimin e Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë, Sistemit për Menaxhimin e Cilësisë dhe Sistemit për Menaxhimin e Sigurimit në KANS, në përputhje me kërkesat ligjore në fushën e aviacionit civil. Ky departament përbëhet nga Divizioni për Siguri, Divizioni për Cilësi dhe Përputhshmëri si dhe Divizioni për Sigurim. Përgjegjësitë kryesore të këtij departamenti janë:

- 2.1 Mbarëvajtja dhe zhvillimi i vazhdueshëm i Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë, Cilësisë dhe

Sigurimit;

- 2.2 Mbikëqyrja dhe sigurimi i zbatimit të standardeve të Sigurisë, Cilësisë dhe Sigurimit;
- 2.3 Identifikimi, vlerësimi dhe menaxhimi i rreziqeve që mund të ndikojnë në sigurinë e fluturimeve;
- 2.4 Zbatimi i masave për parandalimin e aksidenteve dhe incidenteve ajrore;
- 2.5 Monitorimi dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të navigacionit ajror;
- 2.6 Hetimi i ndodhjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e sigurisë;
- 2.7 Siguria fizike e objekteve, sistemeve dhe pajisjeve të KANS.

3. Departamenti për Zhvillim dhe Trajnim - është përgjegjës për përgatitjen e strategjisë zhvillimore të KANS, mirëmbajtjen dhe ngritjen e nivelit të kompetencës së stafit përmes programit të trajnimeve si dhe koordinimin e vlerësimit të kompetencës së rregullt të stafit. Ky departament përbëhet nga Divizioni për Zhvillim dhe Divizioni për Trajnim.

Përgjegjësitë kryesore të këtij departamenti janë:

- 3.1 Të identifikojë nevojat për zhvillim dhe trajnime brenda KANS;
- 3.2 Të krijojë programet e zhvillimit dhe trajnimit në bazë të nevojave të KANS;
- 3.3 Të krijojë Planin Strategjik të Zhvillimit të KANS;
- 3.4 Të përgatisë dhe monitorojë implementimin e Planit të Trajnimeve në KANS;
- 3.5 Të monitorojë procesin e vlerësimit të kompetencës të punonjësve në KANS.

Neni 26

Departamentet Administrative dhe Financiare

1. Departamentet administrative dhe financiare të KANS janë:

- 1.1 DFIN - Departamenti i Financave;
- 1.2 DADM - Departamenti i Administratës;
- 1.3 DBNJ - Departamenti i Burimeve Njerëzore;
- 1.4 DLIG - Departamenti Ligjor;
- 1.5 DPRK - Departamenti i Prokurimit.

2. Departamenti i Financave - është përgjegjës për të gjitha aktivitetet financiare përfshirë përgatitjen e buxhetit, mbajtjen e kontabilitetit të KANS si dhe zhvillimin e strategjive në menaxhimin e qëndrueshmërisë financiare të KANS. Ky departament përbëhet nga Divizioni për Buxhet dhe Tarifa dhe Divizioni për Financa dhe Kontabilitet. Përgjegjësitë kryesore të këtij departamenti janë:

- 2.1 Përgatit propozim-buxhetin dhe kërkesën për ndarje buxhetore dhe ndjekë realizimin e buxhetit;
- 2.2 Siguron zbatimin e detyrimeve të organizatës ndaj shtetit dhe organizmave ndërkombëtare në fushën e financave;

- 2.3 Siguron që të gjitha transaksionet regjistrohen në Regjistrin e Kontabilitetit sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit;
 - 2.4 Pasqyron kostot e shkaktuara në mënyrë të drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë në ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajror;
 - 2.5 Zbaton kërkesat që burojnë nga rregullat mbi Përcaktimin e Skemës së Përbashkët të Tarifave për Shërbimet e Navigacionit Ajror;
 - 2.6 Dorëzon në AACK (Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës), koston bazë për tarifën terminale së bashku me numrin e parashikuar të njërive të shërbimeve të terminalit, të caktuara për secilën zonë tarifore të terminalit.
3. **Departamenti i Administratës** - është përgjegjës të sigurojë dhe mbikëqyrë ofrimin e shërbimeve administrative, menaxhimin e pasurive, transportin dhe logjistikën. Ky departament përbëhet nga Divizioni i Pasurisë dhe Divizioni i Shërbimeve të Përbashkëta. Përgjegjësitë kryesore të këtij departamenti janë:
- 3.1 Siguron mbarëvajtjen e procedurave të menaxhimit të shërbimeve administrative, përkatësisht logjistikë, asete, transport, mirëmbajtje si dhe administron me bazën e të dhënave të pasurive jo financiare;
 - 3.2 Ofron mbështetje teknike dhe operative për KANS për zbatimin e praktikave më të mira të menaxhimit të pasurive (depo, inventar, asete, transport);
 - 3.3 Koordinon të gjitha aktivitetet në lidhje me akomodimin brenda ndërtesës dhe regjistrimin e inventarit;
 - 3.4 Kontrollon dhe mirëmban të gjitha informatat e nevojshme për pasurinë në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.
4. **Departamenti i Burimeve Njerëzore** - është përgjegjës dhe ofron mbështetje, për të gjitha aktivitetet që lidhen me të punësuarit dhe zhvillimin e strategjive në menaxhimin e burimeve njerëzore në KANS. Ky departament përbëhet nga Divizioni i Personelit dhe Divizioni për Paga. Përgjegjësitë kryesore të këtij departamenti janë:
- 4.1 Përgatisë planin vjetor të personelit në pajtim me procesin e planifikimit buxhetor;
 - 4.2 Administrojë me Sistemin Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore;
 - 4.3 Krijojë dhe administrojë dosjen individuale për çdo të punësuar në institucion;
 - 4.4 Sigurojë mbarëvajtjen e procedurave të rekrutimit të nëpunësve, përgatisë konkurset, akt emërimet, kontratat për marrëdhënien e punës dhe procedimin e pagave;
 - 4.5 Përgatisë raporte dhe statistika për personelin në baza mujore, periodike dhe vjetore për numrin e të punësuarve, gjininë, nacionalitetin, moshën, përgatitjen profesionale, gradat dhe pushimet.
5. **Departamenti Ligjor** - është përgjegjës të sigurojë dhe mbikëqyrë të gjitha aktivitetet që lidhen me ofrimin e shërbimeve ligjore në KANS. Përgjegjësitë kryesore të këtij departamenti janë:

- 5.1 Të sigurojë asistencë këshilluese ligjore për KANS;
- 5.2 Të sigurojë hartimin e vendimeve, rekomandimeve, këshillave ligjore dhe akteve të tjera që i nxjerrë KANS;
- 5.3 Të sigurojë dhënien e këshillave juridiko-ligjore në lëmin e së drejtës së aviacionit civil dhe të çështjeve rregullatore ligjore në përgjithësi të fushëveprimit të KANS;
- 5.4 Përfaqësojë dhe mbrojë interesat e KANS para gjykatave dhe institucioneve tjera përkatëse.

6. Departamenti i Prokurimit - është përgjegjës për të gjitha aktivitetet e prokurimit të KANS në pajtim me dispozitat e legjislacionit dhe rregullave të prokurimit dhe zhvillimin e strategjive të prokurimit. Përgjegjësitë kryesore të këtij departamenti janë:

- 6.1 Përgatisë, koordinojë dhe zbatojë planin vjetor të prokurimit dhe të sigurojë zbatimin e këtij plani në pajtim me legjislacionin dhe rregullat e prokurimit publik;
- 6.2 Përcaktojë metodologjinë e prokurimit për tender dhe procedurat e vlerësimit të çmimeve, ofrojë këshilla dhe asistojë menaxhmentin në marrjen e vendimeve lidhur me çështjet kontestuese që mund të dalin në rastet e ekzekutimit të kontratave;
- 6.3 Përgatisë dokumentacionin dhe ftesat për oferta për tenderë dhe dërgimin e tyre për shpallje;
- 6.4 Planifikojë, përpunojë, mbikëqyrë dhe zbatojë në mënyrë efektive furnizimin me mallra dhe shërbime dhe bashkëpunojë me institucionet përkatëse për prokurim publik.

Neni 27

Dispozitat përfundimtare dhe shfuqizuese

- 1. KANS mund të themelojë/shuajë/ndryshojë departamente dhe/apo njësi tjera, bazuar në legjislacionin në fuqi dhe me miratim nga Këshilli Mbikëqyrës, përmes ndryshimit të kësaj rregulloreje.
- 2. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullore për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në ASHNA.
- 3. Brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, Drejtori i Përgjithshëm e themelon komisionin për sistematizimin e vendeve të punës në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje.

Neni 28

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryesuesi i Këshillit Mbikëqyrës të KANS.

Liburn ALIU

Ministër i MMPHI-së
Kryesues i Këshillit Mbikëqyrës - KANS



KANS

KOSOVO • AIR
NAVIGATION
• SERVICES

Titulli: RRB-KANS-01
Versioni: 1.0
Klasifikimi: Brendshëm
Faqe: 16 of 16

SHTOJCA 1: Struktura Organizative e Ofruesit të Shërbimeve të Navigacionit Ajror-KANS

